




KONTRATË – FURNIZIM dhe MONTIM

TITULLI I KONTRATËS 01-370/01-0073739 / 22



Përshkrimi i Kontratës : **Rekonstruimi [Digjitalizimi] i Sallës se Kuvendit në Komunën e Mitrovicës JUGORE.**

Numri i Prokurimit	642-22-4340-1-2-1
Numri i Brendshëm i Prokurimit	642/22/040/121

AUTORITETI KONTRAKTUES: **KOMUNA E MITROVICË E JUGUT.**

OPERATORI EKONOMIK: **TETRONIKS L.L.C., Bedri Shala, p.n, PRISHTINË-Kosovë.**

DATA E NËNSHKRIMIT: **03/08/2022**

PJESA B: KONTRATA – FURNIZIME

KOMUNA- MITROVICË e JUGUT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;
dhe

TETRONIKS L.L.C., Bedri Shala, p.n, PRISHTINË-Kosovë

ne vazhdim "Kontraktori"), me nr Biznesi: **810863325** nr i tel: **+383/ 38/72 22 53** ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike si vijon **Rekonstruimi [Digjitalizimi] i Sallës se Kuvendit.**

si në vijim:

Neni 1 Lënda: **Rekonstruimi [Digjitalizimi] i Sallës se Kuvendit.**

me numër identifikues.

Numri i Prokurimit	642-22-4340-1-2-1
Numri i Brendshëm i Prokurimit	642/22/040/121

1.1 Lënda e kontratës do të jetë [FURNIZIM dhe MONTIM], nga kontraktori i furnizimeve si në vijim:

Lënda e kontratës do të jetë **Rekonstruimi [Digjitalizimi] i Sallës se Kuvendit.**

Operatori fitues i kontrates është i obliguar te furnizoj dhe montoj paisjet sipas specifikave teknike të Detyrueshme në DT dhe Përshkrimin e qmimeve te cilat i ka kërkuar njësia kerkuese [Kryesia e Kuvendit te Komunës së Mitrovices JUGORE].

Rekonstruimi [Digjitalizimi] i Sallës se Kuvendit.	19.940,00 €
---	--------------------

1.2 Kontrata hynë në fuqi : **03/08/2022 dhe përfundon me 03/10/2022 ose 60 ditë**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 5 ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i [kryerjes së **FURNIZIMIT dhe MONTIMIT** është: **Salla e Kuvendit në Objektin e Komunës së Mitrovicës JUGORE.**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë:

Çmimi Total i ofertes së kontraktuar me TVSH është: **19.940,50 €.** [Nëntëmbdhjetë e mijë nënqindë e katërdhjetë euro euro e 50/100 €].

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj sipas situacioneve të furnizimeve dhe montimeve të paisjeve të kryera ose shumën totale të pagesës pas pranimit të punëve të kryera [furnizim dhe montim i paisjeve] dhe pas pranimit të raportit të nënshkruar nga Menaxheri i Kontratës.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i[Furnizimeve] duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit dhe Përshkrimin të çmimeve dhe specifikave teknike të detyrueshme.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj ose 1 vite në bazë të deklaratës së Kontaktorit në ofertën e prezentuar

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [te kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [punëve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c) Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e) Falimenton; f) Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifiko gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dore.

E hartuar në gjuhen [Shqip] [Serbisht] [Anglisht]² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

Për Autoritetin Kontraktues: **Komuna-Mitrovicë e JUGUT**

Emri:	<u>Haxhimet FERATI</u>
Pozita:	<u>Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit</u>
Nënshkrimi:	
Data:	<u>03/08/2022</u>
Vula:	

Për Kontraktorin: **TETRONIKS L.L.C., Bedri Shala, p.n, PRISHTINË-Kosovë.**

Emri:	<u>Almir AJETI</u>
Pozita:	<u>Drejtore</u>
NUI	<u>810863325</u>
Emajl adresa	<u>info@tetroniks.com</u>
Nr i tel	<u>+383/ 38/72 22 53</u>
Nënshkrimi:	
Data:	<u>03/08/2022</u>
Vula:	

KUSHTET E VEÇANTA

NUMRI I MINI TENDERIT: 642-22-4340-1-2-1

KVK NË VIJIM DO TË PLOTËSOJNË DHE/OSE NDRYSHOJNË KPK. SA HERË QË KA NJË KONFLIKT, DISPOZITAT KËTU DO TË MBIZOTËROJNË MBI ATO TË KPK.

KPK		Amandamentimet / Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	1.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	1.2	Gjuha e përdorur do të jetë SHQIPE.
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	1.3	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është: 03/08/2022
	1.4	Data e Përfundimit është: 03/10/2022
	1.5	Vendi i kryerjes së furnizimeve është Komuna e Mitrovicës JUGORE ndërtesa e Kuvendit të Komunes së Mitrovicës JUGORE.
Emrimi i Menaxherit të Kontratës	1.6	Menaxheri i Kontratës është: ,emajl adresa [@rks-gov.net].
Dëmet e likuiduara	1.7	Dëmet e likuiduara për të gjitha furnizimet janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës
Siguria e ekzekutimit	1.8	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është: 1.994,05€ [një mijë e nëntqindë e nëndhjetë e katër euro e 05/100.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	1.9	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: a) Automjeti motorik i Palës së Tretë [N/A] b) Përgjegjësia e Palës së Tretë [N/A]

KONTRATË: Rekonstruimi [Digjitalizimi] i Sallës së Kuvendit.Nr i prokur: 642-22-4340-1-2-1 dhe Nr i brend: 642/22/040/121

		<p>c) Përgjegjësia ndaj punëdhënësit dhe kompensimi i punëtorëve [me marrëveshje të dy palëve]</p> <p>d) Përgjegjësia profesionale [N/A]</p> <p>e) Humbja ose dëmtimi i pajisjeve dhe pronës [N/A]</p>
Parimet e përgjithshme të pagesës	1.10	Orari i pagesës do të jetë: Autoriteti Kontraktues do të paguaj sipas situacioneve të furnizimeve dhe montimeve të paisjeve dhe punëve të kryera ose shumën totale të pagesës pas pranimit të teknik të paisjeve verifikimi të cilësisë dhe raportit të nënshkruar nga Menaxheri I Kontratës
Kontrolli i kualitetit	1.11	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të furnizimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: Periodha Garantuese e Defekteve është [12 muaj ose 1 vitë] sipas ofertes se O.E.-kontraktorit].
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	1.12	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	1.13	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë ose</p> <p>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>

KOSOVIA
 VICA
 30/11/2022

PJESA V E KONTRATËS: IDENTIFIKIMI FINANCIAR

MBAJTËSI I LLOGARISË	
Emri	
Adresa	
Qyteti	
Kodi Postar	
Kontakti	
Telefoni	
Fax	
E-mail	
Numri i TVSH	

BANKA	
Emri	
Adresa	
Qyteti	
Kodi Postar	
Shteti	
Llogaria Bankare	
IBAN (opcionale)	
BIC (Opcionale)	

SHËNIME:

<u>VULA E BANKËS + NËNSHKRIMI I PËRFAQËSUESIT TË BANKËS (Të dyja të obligueshme).</u>

<u>DATA + NËNSHKRIMI I MBAJTËSIT TË LLOGARISË: (e obligueshme).</u>

NENI II-SPECIFIKIMI I QMIMEVE

Numri i Prokurimit: 642-22-4340-i-2-1: Nr i brendshëm : MI 642/22/040/121 – Titulli: Digjital.....i i Salles se Kuvendit - Specifikat (2).

Nr.	OBJEKTI: Rekonstruimi [Digjitalizimi] i Salles se Kuvendit Përshkrimi i POZICIONEVE	Njesia matëse	Sasia	Qmimi për njësi pa TVSH	TVSH-ja	Qmimi për njësi me TVSH	TOTALI i përgjishëm me TVSH
1.	Njesia digjitale e delegatit me mundësi votimi dhe selektor te kanaleve	copë	14	453.12 €	81.56 €	534.68 €	7,485.54 €
2.	Njesia digjitale e delegatit me selektor te kanaleve (pa mundësi votimi)	copë	9	360.88 €	64.96 €	425.84 €	3,832.55 €
3.	Njesia per zgjerim te sistemit te mikrofonave	copë	1	1,171.98 €	210.96 €	1,382.94 €	1,382.94 €
4.	Njesia digjitale e perkthyesit simultan	copë	1	889.21 €	160.06 €	1,049.27 €	1,049.27 €
5.	Kartelat per delegate	copë	1	494.53 €	89.02 €	583.55 €	583.55 €
6.	Smart TV	copë	2	704.71 €	126.85 €	831.56 €	1,663.12 €
7.	Projektor	copë	1	698.88 €	125.80 €	824.68 €	824.68 €
8.	Video shperndares	copë	1	76.24 €	13.72 €	89.96 €	89.96 €
9.	Sistemi i live-streaming permes 2 kamerave min. 2MP	komplet	1	764.49 €	137.61 €	902.10 €	902.10 €
10.	Invertor	komplet	1	930.20 €	167.44 €	1,097.64 €	1,097.64 €
11.	Kablo dhe konektor te ndryshem per nderlidhje	komplet	1	193.77 €	34.88 €	228.65 €	228.65 €
12.	Montimi, instalimi dhe integrimi i pajiseve në sistemin ekzistues	komplet	1	254.24 €	45.76 €	300.00 €	300.00 €
13.	Kontrollimi dhe lëshimi në punë i sistemit ekzistues të zerimit dhe përkthimit simultan	komplet	1	254.24 €	45.76 €	300.00 €	300.00 €
14.	Kontrollimi dhe lëshimi në punë i sistemit ekzistues të votimit elektronik	komplet	1	169.49 €	30.51 €	200.00 €	200.00 €
Gjithsejt TOTALI me TVSH :							19,940.00 €

Vërejtje: Pajset që do te furnizohen dhe montohen duhet të jenë KOMPATIBILE me pajset ekzistuese në Sallën e Kuvendit.

DENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)


EMRI I OË:

TETRONIKS LLC

EMRI DHE MBIEMRI I PERFAQESUESIT TE O.E.

ALMIR AJETI

NENSHKRIMI DHE VULA



DATA: /2022

07/06/2022

SHIPA LLC
tetroniks
PRISHTINE • KOSOVE

Garanci Ekzekutimi



Serial 070010620013799

Për **KUVENDI KOMUNAL MITROVICË**

(emri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)

DUKE PASUR PARASYSH QË

TETRONIKS L.L.C.

(emri i operatorit ekonomik, në tekstin e mëposhtëm "Operatori Ekonomik")

ka marre përsipër të lëshoj një sigurim të realizimit lidhur me kontratën me titull

Rekonstruimi [Digjitalizimi] i Sallës së Kuvendit.

të dhënë me numrin e Prokurimt.

642-22-4340-1-2-1

(Nr. i referencës së prokurimit)

Për Operatorin ekonomik nga Autoriteti Kontraktues;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË Operatori Ekonomik dëshiron të lëshojë një garanci për shumën e sigurimit e specifikuar në dosjen e tenderit nën numrin e dhënë të prokurimit;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË jemi pajtuar t'i japim Operatorit Ekonomik këtë garanci:

PËR KËTO ARSYE vërtetojmë që ne jemi Garantues dhe përgjegjës ndaj juve, në emër të Operatorit Ekonomik, deri në një shumë totale prej

€ 1,994.00

Nje mije dhe Nent qinde dhe Nentedhjetë dhe Kater €

(shuma e garancisë në shifra dhe në fjalë)

dhe ne marrim përsipër të ju pagujmë, me kërkesën tuaj të parë me shkrim që deklarohen që Operatori Ekonomik ka bërë gabim sepse:

- Autoriteti kontraktues është konfrontuar me humbje substanciale që janë rezultat i dështimit të Operatorit Ekonomik për të kryer obligimet e veta sipas kontratës; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo shkakton dëm të konsiderueshëm të Autoritetit kontraktues dhe/ose kërkon nga Autoriteti kontraktues të bëjë shpenzime të konsiderueshme për realizimin e kësaj kontrate; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo ka lënë pa pagesë shumë punëtorë, nënkontraktues, dhe/ose furnizues material; ose
- Ofertë jonormalisht e ulët e dorëzuar nga Operatori Ekonomik zbulon që kjo ofertë nuk mund të realizohet dhe pa asnjë ankesë ose argument, të gjitha shumat brenda limiteve të

€ 1,994.00

siç është thënë më lart, pa pasur nevojë që të dëshmohet ose të jepen (shuma e garancisë)

arsyet ose bazat për kërkesën tuaj ose për shumën e specifikuar këtu.

Kjo garanci është e vlefshme prej datës

03.08.2022

deri më

03.11.2022

Lëshuar në

Drejtoria Qendrore

datë

03.08.2022

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesit

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA

Agjenti: **Ismet Sadiku**

